



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2023:165468

Datë: 30.07.2026

Numri i dokumentit: 09250189

PAKR.nr.291/2026

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Kadrije Goga Lubishtani–kryetare e kolegjit, Mentor Hajraj dhe Arben Hoti–anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Bleona Marmullaku, në çështjen penale kundër të akuzuarit Endrit Nika, për shkak të veprës penale Vrasje e rënde nga neni 173 par.1 pika 1.3 e Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krimeve të Rënda, ankesës së përfaqësuesit të palës së dëmtuar M.M.D, av.Betim Shala dhe ankesës së mbrojtësit të akuzuarit Endrit Nika, av.Tomë Gashi, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krimeve të Rënda, PKR.nr.31/25 dt.19.02.2026, në seancën e kolegjit të mbajtur sipas nenit 390 të KPP-se, më datë 22.06.2026, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. Aprovohet e bazuar** ankesa e mbrojtësit të akuzuarit Endrit Nika, av.Tomë Gashi, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krimeve të Rënda, PKR.nr.31/25 dt.19.02.2026, **anulohet** dhe çështja kthehet në rigjykim.
- II.** Ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, dhe ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar M.M.D, av.Betim Shala, për shkak të vendimi mbi dënim tani për tani janë jo lëndore.

III. Te akuzuarit Endrit Nika, i vazhdohet masa e paraburgimit, pasi që ende ekzistojnë kushtet ligjore, deri ne marrjen e një vendimi tjetër lidhur me këtë mase nga Gjykata Themelore ne Prishtine, Departamenti për Krime te Renda.

A r s y e t i m i

Gjykatës Themelore ne Prishtine-Departamenti për Krime te Renda me aktgjykimin PKR.nr.31/25 dt.19.02.2026, te akuzuarin Endrit Nika, e ka shpallur fajtor për veprën penale Vrasje e rende nga neni 173 par. 1 pika 1.3 te KPRK-së, dhe te njëjtit i ka shqiptuar dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 18 (tetëmbëdhjete) vite, i cili dënim do te ekzekutohet, nga dita kur aktgjykimi te merr formën e prere.

Ne dënimin e shqiptuar me burgim, te akuzuarit do t'i llogaritet edhe koha e kaluar ne masën e paraburgimit, duke llogaritur nga data 01.08.2023, e deri ne plotfuqishmëri te këtij aktgjykimi por jo me shumë se koha e dënimit te shqiptuar sipas aktgjykimit.

Te akuzuarit te lartcekur pas shpalljes se aktgjykimit me aktvendim te veçante me shenjen PKR.nr.31/2025 te datës 19.02.2026 i është vazhduar masa e paraburgimit deri ne plotfuqishmëri te këtij aktgjykimi, por jo me shumë se dënimi i shqiptuar me këtë aktgjykim.

Është detyruar i akuzuari që ne emër te shpenzimeve te procedurës penale te paguaj shumën aq sa bëhen sipas llogarisë përfundimtare te gjykatës, ne emër te paushallit gjyqësor shumën prej 1,000.00 (njëmijë) euro dhe ne emër te taksës për Fondin e Kompensimit te Viktimave te Krimit shumën prej 50,00 (pesëdhjetë) euro e te gjitha këto ne afatin prej 15 ditëve nga dita kur aktgjykimi te merr formën e prere.

E dëmtuara M.M.D për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar ne kontest te rregullt juridiko-civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë kane ushtruar:

- Prokuroria Themelore në Prishtine, Departamenti për krime te renda, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, sipas nenit 383 par. 1 nenpar. 1.4 të KPP-së, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, te aprovoj në tersi ankesën si te bazuar dhe aktgjykimin

e ankimuar ta ndryshoj në pjesën që ka të bëjë me vendimin mbi dënimin, duke i shqiptuar të akuzuarit një dënim më të ashpër dhe proporcional me seriozitetin ekstrem të veprës penale, shkallën e lartë të fajësisë dhe pasojën e shkaktuar.

- Përfaqësuesi i autorizuar i palës se dëmtuar av.Betim Shala, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit, ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar dhe të akuzuarit t'i shqiptoj dënim me burgim të përjetshëm.
- Mbrojtësi i të akuzuarit Endrit Nika, av.Tomë Gashi, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale neni 384 par.1 nenpar.1.1, 1.4 dhe 1.5, par.2 nen par. 2.1 lidhur me nenin 307 par.1 neni 289, neni 290 dhe 291 të KPP-së dhe nenin 384 par. 2 nen paragrafin 2.7 lidhur me nenin 369 par.7 të KPP-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike nga neni 386 par.3 të KPP-së, shkeljes së ligjit penale neni 385 par.1 nen par.1.2 të KPP-së, vendimin lidhur me sanksionin penal nga neni 383 par.1 nenpar.1.4 në lidhje me nenin 387 par.1 dhe 2 të KPP-së. Me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën dhe aktgjykimin e ankimuar ta anuloj ose ta ndryshoj aktgjykimin dhe ta ri kualifikoj veprën penale.

-Përgjigjen në ankesën e përfaqësuesit me autorizim të palës se dëmtuar, av.Betim Shala, ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit Endrit Nika, av.Tomë Gashi, me të cilën ka propozuar që Gjykata e Apelit, ta refuzoj ankesën e përfaqësuesit të palës se dëmtuar, ndërsa ta aprovoj ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtresën PPA.I.nr.254/2026 dt.03.06.2026, Gjykatës së Apelit, i ka propozuar që të aprovohet ankesa e prokurorisë dhe përfaqësuesit të palës se dëmtuar av.Betim Shala, ashtu që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet përkitazi me vendimi mbi dënimin dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i rëndë me burgim proporcional me peshën e veprës së kryer penale, ndërsa të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit Endrit Nika, av. Tomë Gashi, e po ashtu të refuzohet edhe përgjigja në ankese të cilën e ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit kundër ankesës së përfaqësuesit të palës se dëmtuar.

Fillimisht Gjykata e Apelit është siguruar se ankesat e paraqitura pranë kësaj gjykate janë të afatshme dhe të lejueshme, dhe pas vështirimit në shkresat e lëndës konstatoi se të njëjtat janë të parashtruara brenda afatit ligjor sipas nenit 380 par.1 të KPP-së, e po ashtu të njëjta janë të

paraqitura nga personat e autorizuar sipas ligjit, pasi që ne dispozitën ligjore nga neni 381 par.1 të KPP-së, është përcaktuar shprehimisht se ankese mund të paraqes prokurori i shtetit, dhe mbrojtësi i të akuzuarit, ndërsa sipas paragrafit 3 të nenit 381 të KPP-se, i dëmtuari mund të parashtrojë ankese vetëm për vendimin e gjykatës lidhur me sanksionin penal për veprat penale kundër jetës dhe trupit, që ne rastin konkret vepra penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor dhe është dënuar, bije në këtë kapitull të veprave penale, andaj mbi këtë bazë u konstatua se ankesat janë të afatshme dhe të lejueshme, dhe si të tilla i plotësojnë kushtet ligjore që të shqyrtohen në themel.

Gjykata e Apelit e Kosovës, në këtë çështje penale e mbajti seancën e kolegjit me dt. 22.06.2026, sipas dispozitës së nenit 390 të KPP-së, në të cilën prezantuan përfaqësuesi i palës së dëmtuar, av. Betim Shala, i akuzuari Endrit Nika së bashku me mbrojtësin e tij, av. Tomë Gashi, prezent ishte edhe përkthyesi i gjuhës gjermane A.K, ndërsa nuk prezantoi askush nga Prokuroria e Apelit edhe pse të njoftuar me kohe mirëpo mungesën nuk e kanë arsyetuar, po ashtu mungoj edhe e dëmtuara M.M.D për të cilën përfaqësuesi i saj deklaroi se ka qene e njoftuar mirëpo nuk ka mundur që të jete prezent.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar M.M.D, av. Betim Shala, në seancën e kolegjit deklaroi se mbesim në tërësi pranë ankesës së ushtruar dhe diçka tjetër nuk kemi çfarë të shtojmë.

Mbrojtësi i të akuzuarit Endrit Nika, av. Tomë Gashi, në seancën e kolegjit deklaroi se qëndrojmë në tërësi pranë ankesës së ushtruar, duke theksuar se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, madje as gjendja faktike nuk është vërtetuar drejte si dhe i njëjti vazhdoi duke elaboruar detajisht secilin pretendim ankimor të cilat i ka cekur shprehimisht në ankesën e ushtruar dhe në fund propozoi që i akuzuari Endrit Nika, të shpallet i pafajshëm, ose që rasti të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

I akuzuari Endrit Nika, në seancën e kolegjit deklaroi se e mbështes në tërësi mbrojtësin tim dhe diçka tjetër nuk kam çfarë të shtoj.

Gjykata e Apelit pasi shqyrtoi shkresat e lëndës, studioi aktgjykimin e ankimuar sipas dispozitës së nenit 394 par.1 të KPP-së, dhe pasi që vlerësoi pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, përfaqësuesit të palës së dëmtuar dhe pretendimet ankimore të mbrojtësit

te të akuzuarit dhe propozimin e Prokurorisë se Apelit me të gjitha shkresat tjera të lëndës, gjeti se:

Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit është e bazuar.

Pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Prishtinë:

-Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Renda, ka paraqitur ankesë kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë vetëm sa i përket sanksionit penal, me pretendimin se vendimi mbi dënimin nuk është në përputhje me fajësinë e të akuzuarit, vendimi nuk është në përputhje me peshën konkrete të veprës penale, shkallen e jashtëzakonisht të lartë të fajësisë, intensitetin e dhunës së ushtruar ndaj viktimës, mënyrën brutale të kryerjes së veprës penale, pasojën e pakthyeshme të humbjes së jetës si dhe qëllimin e dënimit të përcaktuar me Kodin Penal. Me tej ka shtuar se nga provat personale, materiale dhe ekspertizat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari kishte ushtruar në mënyrë të vazhdueshme dhunë fizike e psikologjike ndaj viktimës, sjellja e cila kulmoi me privimin nga jeta në rrethana të dhunshme dhe degraduese. Nga video incizimet e kamerave të sigurisë është vërtetuar se i akuzuari ka manifestuar sjellje agresive ndaj viktimës edhe para hyrjes në hotelin “S....” duke e tërhequr me forcë, ushtruar kontroll fizik ndaj saj dhe duke e goditur me derën e automjetit. Këto veprime provojnë vazhdimësinë e dhunës dhe ekzistimin e një sjellje sistematike kontrolluese e abuzive ndaj viktimës. Me tej sipas prokurorisë edhe pse gjykata e shkallës së parë ka konstatuar fajësinë e të akuzuarit, ajo nuk u ka dhënë peshën e duhur juridike dhe penale brutalitetit të veprës, intensitetin e dhunës paraprake, sjelljes së të akuzuarit pas ngjarjes, pasojës së pakthyeshme të humbjes së jetës si dhe nevojës për një politike ndëshkimore efektive dhe proporcionale ndaj veprave me të rënda kundër jetës, dënimi i shqiptuar nuk realizon në masë të mjaftueshme qëllimin e dënimit.

Pretendimet ankimore të përfaqësuesit të palës së dëmtuar av.Betim Shala:

-Përfaqësuesi i palës së dëmtuar, kundër aktgjykimit të ankimuar ankesë ka paraqitur sa i përket sanksionit penal me pretendim se gjykata e shkallës së parë ka dështuar të vlerësojë rrethanat renduese për ashpërsimin e dënimit si dhe rrethanat specifike që lidhen me këtë rast. Vlerësimi i gabuar i pasojës së veprës penale, dëmi i pariparueshëm, sjellja e keqe pas kryerjes së veprës dhe tentimi për korrupsion, ekzistenca e femicidit dhe rrezikshmërisë së lartë shoqërore, mos zbatimi i Konventës CEDAW (neni 22 i Kushtetutës së Kosovës) si dhe moszbatimi i konventës së Stambollit dhe shfrytëzimi i cënueshmerisë së viktimës. Andaj mbi bazën e këtyre sipas

përfaqësuesit të palës së dëmtuar kjo ankese është e bazuar dhe gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë rrethanat e përgjithshme të ashpërsimit të dëmit dhe ka propozuar si në propozimin si më lart.

Pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit Endrit Nika, av. Tomë Gashi:

-Në ankese mbrojtësi pretendon se aktgjykimi i shkallës së parë është marrë përmes shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nën par.1.1 të KPP-së, sepse në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të datës 08.09.2025, gjykata ka shënuar se trupi gjykoës përbehet nga gjyqtarët Gazmend Bahtiri, Alltën Murseli dhe Medie Bytyqi, por në të njëjtin procesverbal kryetari i trupit gjykoës ka deklaruar se gjyqtarja Medie Bytyqi, ka avancuar në Departamentin Special nga data 01.09.2025, dhe se gjendet në pushim mjekësor. Nga data 01.09.2025 deri me datë 08.09.2025, nuk ka pasur asnjë seancë që do të thotë se seanca e datës 08.09.2025, është mbajtur pa praninë e gjyqtarës Medie Bytyqi, pra vetëm me dy gjyqtar apo një gjyqtar të ri i cili nuk është shënuar në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor të datës 08.09.2025, se kush është caktuar si gjyqtar i ri, pjesë e trupit gjykoës, çka bie ndesh me nenin 25 par.3 të KPP-së. Me tej sipas mbrojtësit gjykata ka vendosur që shqyrtimi gjyqësor të fillojë rishtazi sipas neni 307 par.1 të KPP-së, por në atë procesverbal nuk e ka përcaktuar se cili gjyqtar është zëvendësuar, duke e lënë të paqartë përbërjen e trupit gjykoës. Ndërsa në procesverbalin e datës 07.10.2025, gjykata ka shënuar në procesverbal një përbërje të re të trupit gjykoës (Gazmend Bahtiri, Alltën Murseli dhe Gëzim Ademi) por nuk e ka përmendur fare nenin 307 dhe nuk e ka filluar rishqyrtimin duke vazhduar shqyrtimin, kjo përbën shkelje të neni 307 par.1 të KPP-së.

-Sipas pretendimeve ankimore të mbrojtësit të akuzuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë edhe në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 1. 4 të ndërlidhura me nenin 14 par.2,3 dhe 4 të KPP-së, pra se gjatë procesit janë evidentuar shkeljet e së drejtës për përkthyes, duke theksuar se i akuzuari është i lindur dhe i rritur në Zvicër, gjithë shkollimin e tij e ka kryer në gjuhën gjermane në Zvicër dhe i njëjti nuk e kupton plotësisht gjuhën shqipe siç ka deklaruar vet në seancën e datës 15.12.2025, megjithatë procedura penale ndaj tij ka filluar që nga shqyrtimi fillestar i datës 21.02.2025, pra plotë dhjetë (10) muaj pa iu siguruar atij përkthyes në gjuhën gjermane dhe kjo përbën shkelje të dispozitave të procedurës penale.

-Me tej mbrojtja ka shtuar se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë edhe në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2 pika 2.1 të KPP-së,

ngase nuk ka zbatuar dispozitat e neneve 289, 290 dhe 291 te KPP-se, qe ndërlidhën me përjashtimin e publikut nga shqyrtimi gjyqësor, për faktin se gjykata ka mbyllur në mënyrë të paligjshëm seancën për publikun me rastin e dhënies se dëshmisë se punëtores- recepsionistes se hotelit “S....”, E.L. Ne kundërshtim me nenin 289 par. 1 dhe par.3 te KPP-së, gjykata e shkallës së parë me date 10.07.2025, ka vendosur mbylljen e seancës për publikun gjate dëgjimit te dëshmitares se larte cekur me aktvendim te bazuar ne nenin 289 par.3 pika 3.2 dhe 3.4 te KPP-së, duke theksuar se neni 289 par.3 pika 3.4 nuk ekziston ne Kodin e Procedurës Penale dhe arsyeja e dhënë nga dëshmitarja-stresi i thelle emocional dhe prezenca e te tjerëve ne salle i pengon te dëshmojë lirshëm nuk përmbush asnjë nga kushtet e nenit 289 te KPP-se.

-Sipas pretendimeve ankimore te mbrojtësit te akuzuarit, ne këtë çështje penale gjykata ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike për faktin se vepra penale për të cilën akuzohej i akuzuari mund te kryhet vetëm me dashje, qofte ajo direkte apo eventuale, e ne rastin konkret dashja vetëm konstatohet mirëpo nuk provohet, ngase ne rastin e Endrit Nikës nuk ekziston dashja. Me tej ka shtuar se gjykata ka keqinterpretuar super ekspertizën e Dr.N.L, Dr. I.D dhe Dr. Sc. A.K, sepse fillimisht kjo ekspertize nuk i plotëson kriteret minimale te një super ekspertizë, sepse nuk ekzistojnë se paku dy ekspertiza te tjera të cilat ne rast te kundërshtimit me njëra tjetrën do te mundësonin propozimin e një super ekspertize. Me tutje ka shtuar se ekspertet ne këtë super ekspertize nuk kane dhënë përgjigje definitive se kush e ka zhvendosur dritaren, si ka rënë dritarja, është nxjerre apo shtyrë etj, por kane konstatuar se dritarja nuk kishte siguresse kundër ngritjes nga poshtë-larte dhe se forca e nevojshme për ngritje vertikale është rreth 27.6 kg. Ky konstatim nuk e përjashton mundësinë që vetë viktimja ta ketë nxjerre dritaren duke u mbështetur me shpinë në dritaren e cila ka rënë për shkak se e njëjta ka qene me gabime teknike e montuar. Duke e interpretuar këtë super ekspertize në mënyrë të njëanshme gjykata ka shkelur nenin 7 dhe 360 par.2 te KPP-së, i cili kërkon vlerësimin e ndërgjegjshëm te secilës prove dhe në lidhje me provat e tjera. Për me tepër në faqen 53 të super ekspertizës ekspertet kanë konstatuar qartë se grupi i eksperteve vlerëson se nuk ka qene forca shtytëse horizontale qe ka zhvendosur dritaren, gjithashtu ekspertet kane theksuar se : si ka ardhur deri te krijimi i forcës vertikale që ka vepruar në dritare me kahje nga poshtë-larte, ekspertet nuk mund ta dinë, sepse nuk kanë të dhëna për dinamiken e zhvillimit të ngjarjes. Ky konstatim i eksperteve e përjashton versionin e prokurorisë për shtyrje horizontale e cila do te ishte e vetmja shtyrje nëse do te ishte bërë nga i akuzuari dhe konfirmon se mekanizmi alternative (ngritja vertikale nga poshtë lart) është jo vetëm i mundshëm, por i vetmi i mundshëm sipas eksperteve. Me tej mbrojtja ka shtuar se ekspertet kane pranuar se nuk mund ta dine se si ka ardhur deri te krijimi i forcës vertikale qe ka vepruar

ne dritare (faqe 53), sipas mbrojtësit ky konstatim është vendimtar për dy arsye se pari ai e përjashton mundësin e shtyrjes horizontale (versioni i prokurorisë) se dyti ai nuk e përjashton mundësinë që vet viktimë duke u mbështetur te dritarja ta këtë nxjerrë atë nga vendi i montimit. Mbrojtësi në ankese ka shtuar se dritarja e re në dhomën te Hotel “S....” nuk është e krahasueshme me dritaren e natës kritike-testet janë të pavlefshme, kur behet fjale për njësit e fuqisë se konstatuar të nevojshme për nxjerrjen e dritares. Me tej mbrojtësi në ankese ka shtuar se me qëllim të ndriçimit dhe vërtetimit të fakteve relevante të kësaj procedure penale është angazhuar një ekspert i fushës së Inxhinierisë Mekanike, Mr.Sc. E.M, i cili ka bërë një vlerësim profesional të shkresave të lëndës dhe të superekspertizës në të cilin mendim janë gjetur mangësi dhe fakte shumë të rëndësishme të cilat nuk janë marrë parasysh në këtë procedure. I njëjti ankesës ia ka bashkangjitur mendimin profesional të ekspertit të lartë cekur. Vërtetimi i gabuar është kontradiktë në lartësinë e rënies së viktimës, ku gjykata në aktgjykimin e saj në faqe 17/46 ka konstatuar se lartësia prej nga ka rënë viktimë është 16.23 metra, megjithatë në super ekspertizë të datës 07.02.2025, ekspertet kanë konstatuar se lartësia është 17.761 metra. Si dhe gjykata ka keq interpretuar edhe dëshminë e dëshmitares Dr. B.G e cila ka dëshmuar se viktimë është përgjigjur “jo” kur e ka pyetur a ke dashur me u hedh vet dhe “jo” kur është pyetur a të ka shtyre dikush. Me tej ka shtuar se gjykata i ka dhënë peshë të gabuar duke i keqinterpretuar ekzistencën të hematomave në trupin e viktimës të cilat ai i ka konstatuar si hematome që nuk ndërlidhen me rënien e viktimës e po ashtu gjykata ka ndërlidhur në mënyrë artificiale grindjen e ndodhur në parking me ngjarjen e ndodhur në dhomë pa asnjë provë që vërteton lidhjen kauzale mes tyre. Po ashtu ka shtuar se distanca kohore në mes të rënies së dritares dhe trupit të viktimës (0.5 sekonda) dëshmon se nuk ka pasur shtyrje duke shtuar se nëse i akuzuari do ta kishte shtyre viktimën dritarja do të kishte rënë shumë më përpara pastaj trupi i viktimës.

Me tej mbrojtësi ka shtuar se aktgjyrimi i nxjerrë përmes shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike ka ardhur deri tek shkelja e ligjit penal me kualifikimin e veprës penale Vrasje e rënde nga neni 173 par.1 nën par.1.3 të KPRK-së duke e konsideruar të ndjerën anëtare të familjes, edhe pse nga provat e administruara rezulton se një lidhje e tillë nuk ekziston, pasi që marrëdhënia mes të akuzuarit dhe viktimës ka zgjatur 5 deri në 6 muaj. Po ashtu mbrojtësi ka shtuar se gjykata e ka dënuar të akuzuarin Endrit Nika me tetëmbëdhjetë (18) vite dënim me burgim duke i injoruar plotësisht rrethanat lehtësuese që i akuzuari Endrit Nika është person pa precedent penal dhe sjelljen e tij pas ngjarjes. Andaj krejt në fund mbrojtësi propozoj që nga të thënat si më lartë ta aprovoj ankesën e mbrojtësit ashtu që aktgjykimin e ankimuar ta anuloj ose ta ndryshoj dhe ta ri kualifikoj veprën penale.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit e Kosovës, e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, detyrimisht në kuptim të dispozitës ligjore të nenit 394 par.1 të KPP-së, vlerësoi pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore ne Prishtine, pretendimet ankimore te përfaqësuesit te palës se dëmtuar av.Betim Shala, dhe pretendimet e mbrojtësit te akuzuarit, së bashku me shkresat tjera të lëndës dhe gjeti se ankesa e mbrojtësit te të akuzuarit Endrit Nika, av.Tomë Gashi, është e bazuar, ngase aktgjykimi i gjykatës se shkallës se pare është i përfshirë ne shkeljet esenciale te dispozitave te procedurës penale, dhe si i tille duhet te anulohet dhe çështja te kthehet ne rigjykim, dhe për këtë arsye gjeti se pretendimet ankimore te Prokurorisë Themelore ne Prishtine, dhe pretendimet ankimore te përfaqësuesit te autorizuar te palës se dëmtuar M.M.D, av.Betim Shala, për shkak te vendimi mbi dënim tani për tani janë jo lëndore.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pas analizimit të aktgjykimit të ankimuar, shqyrtimit të shkresave të lëndës, dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore te mbrojtësit te akuzuarit, gjeti se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nën par.1.1, 1.4 dhe par.2 nenpar 2.1 te KPP-së, te cilat shkelje hyjnë ne shkelje esenciale te dispozitave te procedurës penale të cilat kane kushtëzuar anulimin e aktgjykimit te ankimuar dhe kthimin e kësaj çështje ne rigjykim, për arsyet te cilat do te jepen ne vazhdim.

Kolegji penal i Gjykatës se Apelit, gjene se aktgjykimi i gjykatës se shkallës se pare është i përfshirë ne shkelje esenciale te dispozitave te procedurës penale nga neni 384 par.1 nenpar.1.1 te KPP-se, për faktin se ne procesverbalin e vazhdimit te seancës se shqyrtimit gjyqësor pranë Gjykatës Themelore ne Prishtinë te datës 08.09.2025, në hyrje të këtij procesverbali është konstatuar se trupi gjykues përbëhet prej kryetarit te trupit gjykues gjyqtarit Gazmend Bahtiri dhe anëtarët gjyqtaret Alltën Murseli dhe Medie Bytyqi, ndërsa ne faqen e dyte te të njëjtit procesverbal është konstatuar se shqyrtimi gjyqësor fillon rishtazi për shkak te ndryshimit te përbërjes se trupit gjykues për shkak se anëtarja e trupit gjyqtarja Medie Bytyqi, e caktuar sipas sistemit SMIL, është avancuar ne Departamentin Special te kësaj gjykate nga data 01.09.2025, dhe aktualisht gjendet ne pushim mjekësor. Këto konstatime te gjykatës se shkallës së parë përbejnë një paqartësi dhe konfuzitet për kolegjin penal pasi që ne hyrje si anëtare e trupit gjykues është cekur e njëjta gjyqtare ndërsa ne konstatim te mëvonshëm theksohet se e njëjta është avancuar dhe te njëjtën kohe gjendet ne pushim mjekësor, mirëpo mungon caktimi i gjyqtarit tjetër si zëvendësuesi i saj si anëtar i trupit gjykues. Andaj për kolegjin penal bazuar ne

konstatimet e bëra ne procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor është e paqarte se cila ishte përbërja e trupit gjykues ne atë shqyrtim gjyqësor, pasi qe gjykata e shkalles se pare askund nuk e ka cekur shprehimisht se cili ishte gjyqtari tjetër i cili kishte zëvendësuar gjyqtaren Medije Bytyqi, apo me cilin gjyqtar si anëtar i trete ka vazhduar shqyrtimi gjyqësor, edhe pse kryetari i trupit gjykues ne atë procesverbal te shqyrtimit gjyqësor ka konstatuar se përbërja e trupit gjykues është sipas ligjit, mirëpo nuk dihet se cili ishte gjyqtari i cili ka plotësuar trupin gjykues dhe kjo rrethane e bene te paqarte përbërjen e trupit gjykues ne atë shqyrtim gjyqësor.

-Përveç te cekurave si me larte, kolegji penal i kësaj gjykate gjeti se aktgjykimi i gjykatës se shkalles se pare është marre edhe me shkelje esenciale te dispozitave te procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 1.4 te ndërlidhura me nenin 14 par.2, 3 dhe 4 te KPP-se, për faktin se rezulton se disa nga shqyrtimet gjyqësore ne gjykatën e shkalles se pare janë mbajtur ne gjuhen te cilën me vone ka rezultuar se i akuzuari nuk e ka kuptuar dhe nuk është siguruar përkthimi, për faktin se nga shkresat e lendes ka rezultuar se i akuzuari është lindur dhe rritur ne shtetit e Zvicrës ku ka përfunduar edhe shkollimin ne atë gjuhe, dhe se ne asnjë seance përgjatë gjithë procedurës penale te zhvilluar gjyqësore te akuzuarit nuk i është njoftuar e drejta e tij ne përkthim. Neni 14 par.5 i KPP-së shprehimisht parasheh “Personi nga paragrafi 2, 3 dhe 4 i këtij neni njoftohet për të drejtën e tij në përkthim. Ai mund të heqë dorë nga kjo e drejtë nëse e di gjuhën në të cilën zhvillohet procedura gjyqësore. Nëse personi është i pandehur, heqja dorë e tillë bëhet pasi ai të ketë marrë këshilla ligjore paraprake ose nëse ka njohuri të plota për pasojat e heqjes dorë të tillë dhe që heqja dorë është e qartë dhe e dhënë vullnetarisht. Njoftimi për këtë të drejtë dhe deklarata e pjesëmarrësit ose të pandehurit shënohet në procesverbal”. Ne rastin konkret ne asnjë moment nuk i është lexuar e drejta ne përkthim, përveç një konstatimi ne shqyrtim fillestar te datës 21.02.2025, se i pandehuri deklaroi se nuk ka nevojë për përkthim, qe për kolegjin penal një konstatim i tillë nuk është i mjaftueshëm pasi qe Kodi i Procedurës Penale njoftimin mbi këtë të drejte dhe deklarimin e pjesëmarrësit e parasheh qe te shënohet ne procesverbal, e qe ky obligim ka dështuar te përmbushet nga gjykata e shkalles se pare. Ne seancën e mëvonshme saktësisht ne procesverbalin e datës 15.12.2025, lidhur me parashtresën e mbrojtësit te akuzuarit e cila përmbante kërkesën për caktimin e përkthyesit te njëjtën kohe gjykata e shkalles se pare ka vlerësuar se ne interes te të drejtave te të pandehurit meqenëse i njëjti ka lindur dhe është rrite ne shtetin e Zvicrës e ka me te lehte qe mbrojtjen e tij ta paraqes ne gjuhen gjermano-zviceranë, dhe me këtë nga kjo seance i është caktuar përkthyes i licencuar i gjuhës gjermane. Kolegji penal ve ne dukje se e drejta ne përkthim është e drejte e garantuar me ligj dhe respektimi i saj nuk varet nga vlerësimi diskrecional i gjykatës mbi interesin e te pandehurit.

-Kolegji penal po ashtu gjeti se aktgjykimi i gjykatës se shkalles se pare është përfshirë ne shkelje esenciale te dispozitave te procedurës penale nga neni 384 par.2 nenpar. 2.1 te KPP-se, ngase ka zbatuar gabimisht dispozitën e nenit 289 te KPP-se, qe ndërlidhën me përjashtimin e publikut nga shqyrtimi gjyqësor, për faktin se duke u bazuar ne nenin 289 par.3 nenpar 3.2 dhe 3.4 te KPP-së dhe nenit 290 par.3 te KPP-së, me date 10.07.2025, seanca gjyqësore ne te cilën do te dëshmonte dëshmitarja E.L, gjykata ka marr aktvendim për mbylljen e seancës për publikun, derisa e njëjta te përfundoj dëshminë e saj, me arsyetimin se e njëjta ka stres dhe për ta ruajtur sigurinë qe e njëjta te dëshmoj lirshëm. Për kolegjin penal ky arsyetim nuk përkon aspak me dispozitën ligjore nga neni 289 par. 3 i KPP-së, i cili ne mënyrë te qarte ka parapare rastet kur mund te mbyllet seanca për publikun gjate shqyrtimit gjyqësor, ndërsa ne paragrafin 3 pika 3.2 parashihet se shqyrtimi gjyqësor mund te mbyllet për mbrojtjen e jetës personale ose familjare te te akuzuarit, te dëmtuarit ose pjesëmarrësve tjerë ne procedure, ne vazhdim sipas par.4 te nenit 289 te KPP-se, mbyllja e procedurës sipas nenpar.3.2 te cilës i është referuar gjykata, mund te urdhërohet vetëm kur interesi qe mbështetet nga mbyllja është thelbesisht me i larte sesa interesi publik për procedurën e hapur. Ne rastin konkret gjykata e shkalles se pare shihet se ka marre aktvendim procedural ne procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor për mbylljen e publikut dhe me këtë rast vetëm ka përshkruar dispozitat ligjore, me arsyetimin se dëshmitarja ka stres dhe për ta ruajtur sigurinë qe e njëjta te dëshmoj lirshëm, mirëpo nuk ka arsyetuar me ne hollësi se cilat ishin arsytet për mbylljen e shqyrtimit gjyqësor për publikun se ne cilin aspekt mbrohet jeta personale ose familjare e pjesëmarrësve ne procedure ne rastin konkret e dëshmitares, për me tepër shihet se gjykata referencën ligjore për mbylljen e shqyrtimit gjyqësor për publikun e ka te gabuar ngase bazohet edhe ne nenpar.3.4 te par.3 te nenit 289 te KPP-se, e qe ne fakti fare nuk ekziston ky nenparagraf ne te cilin është bazuar gjykata e shkalles se pare. Arsyetimi i gjykatës se shkalles se pare se shqyrtimi gjyqësor mbyllet ngase deklarimi ne seance te hapur dëshmitares i shkakton stres, për kolegjin penal nuk përbën arsytet për mbylljen e seancës për publikun, pasi qe Kodi i Procedurës Penale parasheh sakte kushtet për mbylljen e seancës për publikun, e qe si i tille veprimi i gjykatës se shkalles se pare me rastin e mbylljes se shqyrtimit gjyqësor për publikun, sipas vlerësimeve te kolegjit penal, paraqet shkelje te dispozitave te procedurës penale.

Shkeljet esenciale te dispozitave te procedurës penale te cekura si me larte sipas vlerësimeve te kolegjit penal janë thelbësore dhe te pakapërcyeshme, duke e bere te domosdoshme anulimin e aktgjyqimit te atakuar dhe kthimin e çështjes ne rigjykim.

-Përveç shkeljeve esenciale te dispozitave te procedurës penale te konstatuara si me larte, pa dyshim qe edhe gjendja faktike nuk është vërtetuar drejt dhe plotësisht, e qe me te drejt pretendohet ne ankesën e mbrojtësit te akuzuarit, prandaj, përveç provave te cilat gjykata e shkalles se pare i ka administruar ne shqyrtimet gjyqësor, për te plotësuar gjendjen faktike ky koleg gjykatës gjene se janë me rëndësi qe te administrohen ne shqyrtim gjyqësor edhe disa prova tjera, konkretisht te dëgjohen edhe dëshmitarët R.N, V.M dhe H.K, për faktin se nga shkresat e lendes rezulton se R.N, ne kohen kur ka ndodhur rasti ishte punëtor i hotelit “S....”, ne F... K..., përkatësisht ishte roje sigurimi dhe sipas dëshmisë se dëshmitares E.L, ky person ka qene ai i cili menjëherë pas saj ka dale ne vendin ku ka qene e shtrire tani viktimja dhe ka dal ne vendin e ngjarjes para se i akuzuari te zbriste poshtë, dhe se i njëjti ka qene personi i cili i ka lajmëruar policinë dhe ambulancën dhe me dëshminë e tij do te vërtetoheshin faktet te rëndësishme për rastin konkret, ndërsa dëshmitaret V.M dhe H.K, nga shkresat e lendes rezulton se te njëjtat janë infermierët te cilat kane shkuar ne vendin e ngjarjes me ambulance se bashku me Dr.B.G., dhe nga aty kane vazhduar me ambulance deri ne QKUK.

-Pasi që është konstatuar se aktgjykimi i gjykatës së shkalës së parë, është i përfshirë me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale te cekura si me larte dhe me vërtetim jo te plote te gjendjes faktike, gjykata e shkalës së parë në rigjykim duhet të ketë kujdes që gjatë punës të zbatoj në përpikëri dispozitën ligjore nga neni 384 të KPP-se, që t’i thërras të gjithë personat të cilat janë me rëndësi për të vërtetuar ekzistimin apo mos ekzistimin e veprës penale, të thërras të gjithë personat që duhet të jenë në shqyrtim gjyqësor, që trupi gjykues të jetë i formuar konformë ligjit, qe te sigurohet përkthimi adekuat ne gjuhen te cilën e kupton i akuzuari, që të vendos që gjykimi të jetë publik, që të veproj konform aktit akuzues të ngritur nga ana e prokurorisë, që i akuzuari të deklarohet lidhur me veprën penale e cila i vihet në barrë, që gjatë zbatimit të ligjit të zbatohen të gjitha dispozitat ligjore, duke u vlerësuar dispozitat ligjore, nga neni 7 i KPP-se, që të gjitha organet të zbatojnë në përpikëri autorizimet që i kanë, që të gjitha provat do të procedohen të kenë të përmbushura anën formalo-juridike.

-Me qellim te plotësimit te gjendjes faktike ne mënyrë sa me te drejte dhe te plote ne rigjykim, gjykata e shkalles se pare te thërras dhe t’i dëgjojë ne cilësinë e dëshmitarëve R.N, V.M dhe H.K, dhe te njëjtit te dëgjohen për rrethanat e rastit, kjo për faktin se nga shkresat e lendes rezulton se R.N, ne kohen kur ka ndodhur rasti ishte punëtor i hotelit “S....”, ne F... K..., përkatësisht ishte roje sigurimi dhe sipas dëshmisë se dëshmitares E.L, ky person ka qene ai i cili menjëherë pas saj ka dale ne vendin ku ka qene e shtrire tani viktimja dhe ka dal ne vendin e

ngjarjes para se i akuzuari te zbriste poshtë, i njëjti ka qene i cili ka lajmëruar policinë dhe ambulancën, sa i përket dëshmitareve V.M dhe H.K, nga shkresat e lendes rezulton se te njëjtat janë infermierët te cilat kane shkuar ne vendin e ngjarjes me ambulance se bashku me Dr.B. G., dhe nga aty kane vazhduar me ambulance deri ne QKUK. Po ashtu pasi qe gjykata e shkalles se pare ka hartuar aktgjykimin, mbrojtësi i te akuzuarit av.Tomë Gashi, ne procedurën e ankesën ka angazhuar ekspertin e pavarur te fushës se inxhinierisë mekanike Mr.sc.E. M., dhe tani ne shkresat e lendes gjendet ekspertiza e punuar nga ky ekspert, ne rigjykim, gjykata e shkalles se pare te vlerësoj dhe krahasojë këtë ekspertize me ekspertizën paraprake e cila është hartuar gjate procedurës ne gjykatën e shkalles se pare dhe nëse gjen konstatime te kundërta mes këtyre dy ekspertizave për fakte te rëndësishme te mbetet ne vlerësimin e gjykatës se shkalles se pare te veproje sipas dispozitës ligjore nga neni 140 te KPP-se, pastaj gjykata e shkalles se pare me rastin e hartimit te aktgjykimit të jepet arsyeja konkrete për çdo pikë të aktgjykimit, pasi që të vihet në përfundim se dispozita ligjore nga neni 369 e KPP-se, është zbatuar, duke përmbajtur formën e aktgjykimit me shkrim.

-Sa i përket pretendimeve ankimore te mbrojtësit te te akuzuarit për shkeljet e ligjit penal dhe për sanksion penal, si dhe pretendimeve ankimore te prokurorisë dhe përfaqësuesit te palës se dëmtuar për vendim mbi dënimi, kolegji penale i kësaj gjykate nuk u lëshua ne vlerësimin e këtyre pretendimeve ankimore, meqenëse konstatoj se aktgjykimi i gjykatës se shkalles se pare është i përfshirë ne shkelje esenciale te dispozitave te procedurës penale dhe ne vërtetim jo te plote te gjendjes faktike, të cilat shkelje kane kushtëzuar anulimin e aktgjykimit dhe kthimin e çështjes ne rigjykim.

-Gjykata e Apelit si rezultat i shkeljeve te konstatuara si me larte nuk ka mundur qe te veproje sipas nenit 403 te KPP-se, pasi qe për shkak të shkeljeve esenciale te dispozitave te procedurës penale dhe vërtetimit jo te plote te gjendjes faktike, ka vlerësuar se duhet urdhëruar shqyrtim të ri gjyqësor në Gjykatë Themelore për të përsëritur shqyrtimin e provave dhe marrjen edhe te provave te reja, krejt kjo me qellim te eliminimit te shkeljeve esenciale te konstatuara me larte dhe vërtetimit te plote te gjendjes faktike ne këtë çështje penale.

-Sa i përket çështjes së paraburgimit, kjo mase është vazhduar kundër të akuzuarit Endrit Nika, në kuptim të nenit 402 par.5 i KPP-se, pasi që ekzistojnë kushtet ligjore, për vazhdimin e kësaj mase, deri ne marrjen e një vendimi tjetër nga Gjykata Themelore ne Prishtine-Departamenti për Krime te Renda.

-Nga sa u tha më lartë e në kuptim me dispozitën e nenit 402 të KPP-se u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti për Krime te Renda
PAKR.nr. 291/2026 më datë 22.06.2026

B. profesionale
Bleona Marmullaku

Anëtarët e kolegjit
Mentor Hajraj

Arben Hoti

Kryetare e kolegjit
Kadrije Goga Lubishtani
